



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0072093/22-3 dt. 08.08.2022
Mitrovicë

01 Nr. Protokollit: 02-060/01-0072093/22-3
Nr. Ligjërës: _____
Data/Datumi: 08-08-2022
Shtetas: Mitrovicë - Mitrovica

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenin 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 08.08.2022, pasi rishqyrtoi Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0057834/22-4 dt. 29.06.2022 Për bartjen e pjesës së mbetur të të hyrave vetanake nga viti 2021 në buxhetin e vitit 2022, sjell këtë:

VENDIM

Për bartjen e pjesës së mbetur të të hyrave vetanake nga viti 2021 në buxhetin e vitit 2022

- MIRATOHET Vendimi për BARTJEN e pjesës së mbetur të të hyrave vetanake nga viti 2021 në buxhetin e vitit 2022.
- Shuma e mjeteve të bartura sipas pikës 1 të këtij vendimi është 232,224.74 €.
- Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi destinohet për kategoritë ekonomike Subvencione dhe transfere.
- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tabelare:
 - Tabela 1, - shpërndarja sipas programeve buxhetore;
 - Tabela 2, - arsyeshmëria e bartjes;
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik.
- Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0057834/22-4 dt. 29.06.2022 Për bartjen e pjesës së mbetur të të hyrave vetanake nga viti 2021 në buxhetin e vitit 2022.
- Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
1 x 1 MAP
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha drejtorive

